

RELACION TEKNIK

Kontrata: Mirembajtje me performance rruga Kthese Patos - Ballsh + rruga Ballsh-Fratar(Mallakaster) + rruga Ballsh - Aranitas + rruga Metohasim – Kafaraj (K/Frakull-Kashishte) + rruga K/Rr Ncionale – Bylis 61.4 km

1. Qëllimi i Shërbimeve që do kryhen

Shërbimet që do mundësohen përfshijnë gjithë veprimtaritë, fizike dhe të tjera, që duhet të kryhen, sipas përputhshmërisë së tyre me Nivelet e Shërbimit dhe kriterin e caktuar të realizimit të tyre të performancës, apo me çdo kërkesë tjetër.

Në vecanti, ato përfshijnë detyrat menaxheriale dhe punimet fizike që lidhen me asetet dhe zërat që lidhen me rrugën:

- Asfaltimet
- Bankinat
- Sinjalistika dhe furnizimi pajisjet për sigurinë rrugore
- Strukturat e drenazhimit
- Kontrolli i vegjetacionit
- Skarpatat (gërmimet dhe bankinat)
- Veprat e artit
- Menaxhimi i trafikut
- Grumbullimi i dherave
- Pastrimi i dëborës (nqs ka mirëmbajtje dimërore)

Shërbimet që kërkon Mirëmbajtja e një rruge klasifikohen në:

2. Punimet Rehabilituese/periodike, në formën e sasisë së një vlere tavan, ndërsa tregohen sasi të punimeve të matëshme që do kryhen në mënyrë që rruga të arrijë Standardet e asaj performancë.
3. Shërbimet e Mirëmbajtjes Rutinë në formën e sasisë së shprehur në një vlerë tavan mujore (kjo do jetë një sasi mujore e aplikueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së shprehur në çmim për kilometër për secilin muaj e shumëzuar me gjatësinë e rrugës dhe kohëzgjatjen e shërbimeve);
4. Punimet Emergjente në formën e një preventivi tradicional.

Funksionet kryesore të bazave të mirëmbajtjes në përgjithësi, duhet të jenë si më poshtë:

1. Mbikëqyrja e segmentit/seksionit rrugor në periudha të caktuara sipas niveleve të shërbimit
2. Kontrolli i të dhënave të trafikut për këtë segment
3. Vëzhgimi i faktorëve meteorologjikë
4. Ndihma e parë në rast aksidenti (në lidhje me elementët e rrugës dhe trafikut)
5. Mirëmbajtje në kushtet e dëshiruara të shtresave rrugore
6. Mirëmbajtja e hapësirave të parkimit, shërbimit, shenjave rrugore, sistemeve të ndriçimit, sinjalizimit të ardhshëm e telekomunikacionit.
7. Riparime dhe rindërtim pas aksidenteve rrugore
8. Riparime dhe rindërtim pas fatkeqësive natyrore

9. Operacionet e pastrimit të drenazheve, tombinove dhe objekteve të tjera që lidhen me largimin e ujrave nga sipërfaqja e rrugës

10. Të gjithë operacionet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e :

- shenjave rrugore, pajisjeve të sigurise (gardhe, parapet) sistemi i ndricimit.
- riparimi lokal i dëmtimeve të trotuarit
- kujdesi për bimesinë
- aktiviteti në dimer për largimin e dëborës dhe akullit.

Punimet e mirëmbajtjes në kushtet dimërore, përfshijnë:

1. Punime paraprake para fillimit të kushteve të dimrit
2. Organizimi i vendodhjeve të depozitimit të materialeve
3. Masat mbrojtëse për borën, akullin, grumbujt e borës dhe ortekët
4. Pastrimi i dëborës nga karrexhata e autostrades dhe sinjalet e komunikacionit dhe shenjat
5. Shenjimi i anëve të karrexhatës
6. Sigurimi i funksionimit të drenazhimit nga karrexhata
7. Heqjen e automjeteve nga rruga
8. Instalimi i sinjaleve të vecanta të komunikacionit në rastet e rregjimit të trafikut të veçantë të mbylljes së rrugës.
9. Informimi i vazhdueshëm i publikut për gjëndjen e rrugës dhe rrjedhën e trafikut.

5. Segmentet që mbulon kontrata

Nr. Rrugës	Nr. Rendor	Emërtimi i Rrugëve	Tipi rrugës	Gjatësia totale (km)	Gjerësia (m)
4	1	Kthese Patos - Ballsh	SHL	20.6	6
4	2	Ballsh-Fratar(Mallakaster)	SHL	20.5	6
ska	3	Ballsh - Aranitas	SHL	6	5
ska	4	Metohasim – Kafaraj(K/Frakull-Kashishte)	SHL	8.5	4.5
ska	5	K/Rr Ncionale - Bylis	SHL	5.8	4
SHUMA E KONTRATES				61.4	

Shënim: SFL – rrugë në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore, SHL – rrugë në terren kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore, SMTW – rrugë në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.


6. Kusht i veçantë

Për çdo rast, nga kontrata do të zbriten segmente të saj nqs do të përfshihen në investim (rikonstrukcion) apo projekte të tjera të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

7. Sinjalistika dhe siguria rrugore

Mirëmbajtja e sinjalistikës dhe siguria rrugore (barrierat) do të fokusohet tek riparimi dhe rifreskimi e asaj ekzistuese.

8. Përshkrimi i zonës ku ndodhet rruga



Fier(kthese Patosi) - Visoke (Oficine e vjeter)

Ky segment është pjesë e aksit rrugor që lidh Fierin me Patosin dhe Ballshin .

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike janë në gjendje të amortizuar për shkak të qarkullimit të mjeteve të tonazhit të rëndë që mbushen me naftë dhe inerte në Mallakastër prandaj duhen mbajtur në monitorim të vazhdueshëm.

Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.


Në disa ura dhe tombino duhet të riparohen harkoret e betonit

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme.

Rruga është në terren kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Për shkak të terrenit nga km 13 -15 skarpatet nuk janë të qëndrueshëm, duhet mbajtur në kontroll të vazhdueshëm.

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.



Rr.Visoke-Fratar(Mallakaster)

Ky segment është pjesë e aksit rrugor që lidh Fierin me Patosin, me Ballshin dhe zonen e Mallakastres.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe levizje .

Shtresat asfaltike janë tejet të amortizuara për shkak të qarkullimit të mjeteve të tonazhit të rëndë që mbushen me naftë dhe inerte në Mallakaster prandaj duhen mbajtur në monitorim të vazhdueshëm.

Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pasrim të vazhdueshëm për shkak të terrenit të thyer ka prurje të dherave dhe inerte gjatë periudhës së shirave.

Në disa ura dhe tombino duhet të riparohen harkoret e betonit.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme.

Rruga është në terren kodrinor me një karrexhatë me dy kahe levizje, pa mirëmbajtje dimërore.

Problematike janë shkarjet e njëpasnjeshme në gjithë gjatësinë e tij, disa kërkojnë nderhyrje me investim.

1-Shkjarje 50 m në dalje të Ballshit rreth km 11.8 në krahun e majtë e cila gjatë periudhës së dimrit është problematike. Për të zgjidhur problemin duhet ndërtuar mure mbajtës në mënyrë që të eliminohen shkarjet e dherave.

2-Shkarja në km 11.6 në anën e majtë 50 m Qafe Kashi

3-Shkarje rreth 100 m rreth km 12.2 pas lokalitetit të depoja e ujit nga e djathta .Si rezultat i kësaj shkarje rruga është ngushtuar(eshtë bërë me gjerësi 4m).

4-Shkarje rreth 20 m te rezervuari i Kojlacit rreth km 12.6 .

5-Shkarje rreth 20 m nga e djathta rreth km 13.1.

6-Shkarje 25 m rreth km 13.4.

7-Shkarje 30 m ne Qafen e Sykuqit nga e djathta rreth km 16.1

8-Shkarje 30 m ne kthesen e forte pas guardreles ne km 16.5

Cedimet e medha te kthesat e forta ne Greshice rreth km 20 rreth 200 m.

9-Shkarje rreth 100 ne Greshice pa vajtur ne Povel rreth km 21.9

10-Shkarje rreth 200 m rreth km 22.2.

11-Shkarje 100 m rreth km 22.6 deri te km 22.8 te kthesa e forte kur zbresim per ne Povel.


12-Shkarje rreth 30 m rreth km 23 ketu ka dhe cedim te theksuar

13-Shkarje rreth 200 m te pjesa me cakull para shkarjes se Povles rreth km 23.7

14-Shkarje rreth 100 para ures se Povles rreth km 24, rruga eshte ngushtuar dhe eshte bere 2.5 m gjeresi

15-Shkarje deri ne 65 m rreth km 24 .9 rruga eshte ngushtuar eshte bere 3m gjeresi

Niveli i kerkuar i shërbimit “i mire”.



Ballsh-Aranitas

Ky segment rrugor është degëzim djathtas të kthesës së Uzines Ballsh.

Lidh Fshatrat e Mallakastres me Ballshin.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Urat dhe tombinot janë në gjendje të mirë në përgjithësi, me përjashtim të urës në km 3.8 ku ka dëmtim të murit të gurit (në dalje të Panahorit).

Problematike nëselet qarkullimi i mjeteve të tonazhit të rëndë që mbushen me naftë ose inerte në Aranitas.


Shtresat asfaltike janë në gjendje të mirë në përgjithësi por kërkon nderhyrje me riveshje rreth km 5.5-6 ku ka patur çarje dhe cedim të rruges.

Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të vazhdueshëm.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesëshme.

Rruga është në terren kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.



Rr. Metohasim – Kafaraj (K/Frakull – Kashisht)

Ky segment rrugor është degëzim djathtas në fshatin Peshtan që lidh fshatrat përreth me autostradën dhe me qytetin e Fierit.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike janë në gjendje të mirë me nevojë të pakta për riparime.

Kanalet anësore, tobinot dhe kunetat kanë nevojë për pastrim të vazhdueshëm sepse ka prurje të aluvioneve gjatë periudhës së shirave.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjeshme.

Rruga është në terren kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.



Rr.Kryq.Rruga Nationale-Bylis

Ky aks lidh Parkun Kombetar Bylis si dhe fshatrat perreth.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Urat dhe tombinot janë në gjendje të mirë .

Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të vazhdueshëm.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjeshme.

Rruga është në terren kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Në këtë aks ka cedim të rrugës para shkarjes rreth 100 m gjatësi afersisht rreth km 1.7 e cila kërkon ndërhyrje me investim për ta sjellë rrugën në gjendje normale.

Problematike në këtë aks është dhe shkarja të km 2.2-2.3 rreth 100 m majtas dhe djathtas e cila ka carje të murit ,për ta sjellë në gjendje normale kërkon ndërhyrje me investim.

Në km 3.9 në djathtë ka cedim të rrugës rreth 25 m e cila kërkon ndërhyrje për të normalizuar gjendjen.

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.